

Aktiviteti USAID Kosovo Compete

Aktiviteti USAID Kosovo Compete, synon të lehtësoj konkurrueshmërinë e sektorit privat në përputhje me rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë si dhe përdor qasjen e sistemit të tregut të përafuar me politikën e USAID për angazhimin e sektorit privat.

Objektivi i përgjithshëm i aktivitetit USAID Kosovo Compete është të promovoj sisteme të qëndrueshme dhe të vetmjaftueshme të tregut dhe të lehtësoj përmirësimin e konkurrueshmërisë së këtij sektori në tregjet lokale, rajonale dhe globale.

Objektivi specifik i aktivitetit USAID Kosovo Compete është që në mënyrë të qëndrueshme të rris konkurrueshmërinë e sektorëve të ekonomisë që janë të orientuar në eksport, përpunim të drurit, teknologji të informimit dhe komunikimit (TIK) dhe përpunim të ushqimit, përmes identifikimit dhe menaxhimit të pengesave dhe kufizimeve në të gjithë sistemin e tregut.

Partnerët e aktivitetit USAID Kosovo Compete, përfshirë shoqatat e industrisë, ofruesit e shërbimeve, institucionet qeveritare dhe kompanitë, do të përqafojnë fuqinë e zgjidhjeve të bazuara në treg si instrument për të siguruar vetmjaftueshmërinë dhe qëndrueshmërinë përball kufizimeve të sistemit të tregut. Kjo do u ndihmoj të përmirësojnë performancën e industrisë në të ardhmen dhe përmirësimin e kontributit të saj në rritjen ekonomike.

Aktiviteti USAID Kosovo Compete do të siguroj një programim efektiv në rritje me partnerët që punojnë përgjatë tre sektorëve dhe që janë të organizuar në pesë fusha funksionale: a) qasja në treg; b) financim i diversifikuar; c) sofistikimi i biznesit; d) zhvillimi i shkathëtësive; dhe e) mbështetja e mjedisit të biznesit. Intervenimet pritet të shërbejnë si model për akterët e sektorëve dhe fushave të tjera funksionale të cilat aktiviteti USAID Kosovo Compete nuk i mbështet drejtpërdrejt.

Gjatë pesë viteve të ardhshme (gusht 2020 – gusht 2025), aktiviteti USAID Kosovo Compete do të ndihmoj firmat, organizatat dhe institucionet e sektorëve kryesor të orientuar në eksport që në mënyrë të qëndrueshme të rrisin konkurrueshmërinë. Duke punuar në adresimin e kufizimeve përgjatë gjithë sistemit, aktiviteti USAID Kosovo Compete do të mundësoj një ndryshim të shkallëzuar dhe sistemik, do të stimuloj krijimin e vendeve të punës si dhe do nxis rritjen e mundësisë së sektorit privat që të përfshihet në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Rezultatet e pritura në të tre sektorët parashihen të jenë: 1) forcimi i sistemeve të tregjeve për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit; dhe 2) akterët e tregut në këto sistemeve të tregut të jenë më produktiv dhe konkurrues.

Aktiviteti USAID Kosovo Compete do të bëjë përpjekje shesë që të lidh resursin e njohurive (*ang. know-how*) të diasporës me bizneset e udhëhequra nga të rinjtë, gratë dhe minoritetet. Këto përpjekje janë të shumë të rëndësishme për lehtësimin e një qasje të përmirësuar në tregjet jashtë vendit, zhvillimin e tregjeve të reja si dhe rritjen e lidhjeve dhe mundësive. Në këtë drejtim, aktiviteti USAID Kosovo Compete do të zhvilloj një qasje të përshtatur për të promovuar lidhjet mes bizneseve lokale dhe pjesëtarëve të diasporës të angazhuara në industri të ngjashme konkurruese jashtë vendit. Aktivitetet që synojnë fuqizimin e grave, të rinjve dhe minoriteteve janë elemente përbërëse të aktivitetit USAID Kosovo Compete.